



Republika e Kosovës,
Kuvendi i Komunës së Junikut,
Numër: 02-/01/
Datë: 14.02.2023



Në bazë të nenit 8 paragrafi 8.3 të Rregullores për punën e komiteeve të Kuvendit të Komunës së Junikut dhe në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal Nr.002/04 i datës 31.05.2018, kryesuesja e Komitetit për Komunitete të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Komitetit për Komunitete,
Nga: Zejnepe Gaxherri – kryesuese e Komitetit për Komunitete të Komunës së Junikut,
Lënda: Mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete,
Vendi: Salla e takimeve kati parë,
Data: 22.02.2023, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundi;
2. Shqyrtimi i Raportit të Punës për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2023;
4. Hartimi i orarit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Komunitete;
5. Informatë rreth qështjeve dhe kërkesave të komunitetit;
6. Të ndryshme;



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02/09/22

Datë: 21. 12. 2022, ora 11⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen Nëntë të Rregullt të Komitetit për Komunitete, mbajtur me datën 21 Dhjetor 2022, në orën 11⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Zejnepe Gaxherri - kryesuese, përfaqësuese (LDK),
2. Zenel Maloku - përfaqësues (AAK),
3. Eliza Pepshi - përfaqësuese (LVV),
4. Valdrin Isufaj - përfaqësues (Komuniteti i Biznesit), dhe
5. Safete Shehu - përfaqësuese (OJQ Qershiza).

Mbledhjen e Nëntë të Rregullt të Komitetit për Komunitete e kryesoj znjsh. Zejnepe Gaxherri, ndërsa prezantoi dhe kërkoi miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit,
2. Diskutim rreth temës kundër dhunës në familje, dhe
3. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u shqyrtua dhe u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Parë e Rendit të Ditës
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit, i cili shqyrtua dhe u miratua nga të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës
Diskutim rreth temës kundër dhunës në familje

Për raportim rreth kësaj pike të Rendit të Ditës fjalën e mori znj. Safete Shehu e cila tha, ne si OJQ, kemi pasur aktivitete të ndryshme për dhunën në familje. Kemi pasur edhe një aktivitet me organizatën “Human”, e cila merret edhe me antikorrupsionin dhe ligjëron nëpër shkolla në Kosovë.

Propozimi im për dhunë në familje është që kjo të mësohet si lëndë mësimore në shkolla, sepse dhuna në familje është mjaftë e theksuar.

Është mirë që edhe Komuna të përkrah shoqërinë civile për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, siç është fillimisht vetëdijesimi i fëmijëve, sepse ka dhunë edhe tek fëmijët edhe kur kjo shkaktohet nga ana e prindërve të tyre. Dhunë ka edhe te të gjitha shtresat e shoqërisë. Pra, kërkohet vetëdijesim i të gjitha këtyre shtresave në përgjithësi.

Anëtarët e Komitetit për Komunitete u pajtuan me vlerësimin e znj. Safete Shehu, ndërsa kërkuan nga institucionet që kjo çështje të merret seriozisht, dhe të krijohen kushte për viktimat e dhunës në familje, siç janë; mbrojtja, strehimi, kujdesi, sistemimi, e të tjera.

Në vazhdim znj. Safete Shehu, theksoj së Komuna asnjëherë nuk ka ndarë buxhet për aktivitetet e Shoqërisë Civile, ndërsa kërkoj që kjo të bëhet në të ardhmen.

Z. Zenel Maloku tha, për këtë duhet të bëhet kërkesë dhe të paraqiten projektet e Shoqërisë Civile, pastaj kjo duhet të përmbushet nga Komuna, pra të sigurohen fonde nga Komuna.

Pika e Tretë e Rendit të Ditës
Të ndryshme

Z. Zenel Malokut, ne kemi kërkuar rregullimin Qendrës së Junikut, si dhe largimin apo ç ‘vendosjen e Postës së Kosovës nga Qendra e Junikut, mirëpo këto nuk kanë ndodhur, kjo për shkak të shpronësimeve të cilat duhet të kompensohen. Pra, për të gjitha këto bëhen me vendim të Kuvendit, dhe sipas ligjeve në fuqi në bazë të çmimeve të tregut.

Znj. Safete Shehu tha, është problem largimi i bizneseve apo lokaleve afariste nga Qendra e Junikut, sepse disa nga to janë të vetmet të ardhura të këtyre pronarëve.

Z. Zenel Maloku tha, bizneset dhe secili duhet të ndërtoj objektet e tyre në pronën e tyre, por nëse është interesi i Komunës apo shtetit atëherë ato shpronësohen dhe kompensohen nga Komuna, përkatësisht shteti.

Znj. Safete Shehu tha, unë kam edhe një pyetje tjetër, që është se kur do të bëhet furnizimi me ujë të pijes në lagjen “Agim Ramadani”?

Z. Zenel Maloku tha, një kërkesë e tillë është bërë që 12 vite, por kjo asnjëherë nuk është kryer. Punimet kanë filluar por nuk kanë shkuar ashtu siç duhet, kanë shkuar në bazë të interesave personale të disave, dhe pastaj kanë ndryshuar çmimet dhe kjo është ndërprerë nga operatori. Por siç duket punimet kanë filluar prapë dhe kanë arritur deri të kyçja e gypave të ujit, ndërkohë kam dëgjuar që janë duke u bërë dy kroje, një në lagjen e poshtme dhe tjetra në lagjen e epërme. Pra, kjo derisa të bëhet zgjidhja përfundimtare për furnizimin e gjithë lagjes “Agim Ramadani”.

Z. Valdrin Isufaj tha se deputetët në Asamble duhet të kushtëzohen me votë, dhe poashtu të kushtëzohet edhe miratimi i buxhetit për realizimin këtij projekti.

Me kaq, kryesuesja znjsh. Zejnepe Gaxherri e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotshme të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtësi,

Gëzim Geci

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete,

Zejnepe Gaxherri



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Vendi: Komuna e Junikut
Hartuesi: Komiteti për Komunitete
Lloji i punës: Raport pune

**“RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
PËR VITIN 2022”**

Junik, janar 2023

1

Komiteti për Komunitete me qëllim të realizimit të detyrave të punës në përputhje me Rregulloren e Punës së Komiteteve të Komunës së Junikut dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale për vitin 2018 harton këtë:

RAPORT P U N E

Hyrje:

Komiteti për Komunitete është organ i formuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut në harmoni me Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregullores së punës së Kuvendit.

Misioni:

Siç është përshkruar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Komiteti për Komunitete është përgjegjës për të trajtuar çfarëdo çështje që ka të bëjë me diskriminimin e një personi mbi çfarëdo baze siç është: gjuha, religjioni, prejardhja etnike, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me interesin e një komuniteti.

Komiteti për Komunitete numëron gjithsej 5 anëtarë prej të cilëve 3 janë femra dhe 2 meshkuj, në komitet është një përfaqësues i subjektit politik LDK, një përfaqësues i subjektit politik AAK, një përfaqësues i subjektit politik LVV, një përfaqësues i komunitetit të biznesit dhe një përfaqësues i OJQ -ve.

Gjatë vitit 2022 Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje të rregullta. Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunitetet e Junikut.

Muaji:	Numri i mbledhjeve:	Aktivitetet:
Mars	Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none">1. Caktimi i orarit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022;3. Informatë rreth aktiviteteve sportive dhe kulturore në komunë;4. Të ndryshme.
Prill	Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none">1. Caktimi i orarit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

		<p>2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022;</p> <p>3. Informatë rreth aktiviteteve sportive dhe kulturore në komunë;</p> <p>4. Të ndryshme.</p>
Maj	Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<p>1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</p> <p>2. Informatë lidhur me shërbimet e pacientëve që ofrohen nga ana e QMF-së në Junik.</p> <p>3. Informatë e kryetarit të komunës rreth gjendjes financiare dhe ekonomike të Komunës së Junikut;</p> <p>4. Të ndryshme.</p>
Qershor	Mbledhja e katert e rregullt e Komitetit për Komunitete	<p>1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</p> <p>2. Informatë rreth mirëmbajtjes verore të rrugëve lokale në komunën e Junikut.</p> <p>3. Të ndryshme.</p>
Korrik	Mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<p>1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</p> <p>2. Informatë rreth suksesit të nxënësve dhe realizimit të planprogramit me rastin e përfundimit të vitit shkollor 2021-2022.</p> <p>3. Të ndryshme.</p>
Gusht	Mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<p>1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</p> <p>2. Informatë rreth përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor 2022-2023.</p> <p>3. Informatë rreth gjendjes së pyjeve në komunën e Junikut.</p>

		4. Të ndryshme.
Shtator	Mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth përfshirjes së nxënësve në aktivitete kulturore dhe sportive në komunën e Junikut; 3. Të ndryshme.
Tetor	Mbledhja e nëntë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Siguria e nxënësve në shkollën fillore dhe të mesme në Komunën e Junikut; 3. Informatë e kryetarit të komunës rreth gjendjes financiare dhe ekonomike të Komunës së Junikut; 4. Të ndryshme.
Nentot	Mbledhja e dhjetë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth planit për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në komunën e Junikut. 3. Përgatitja e projektplanit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023. 4. Të ndryshme.
Dhjetor	Mbledhja e katert e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë e kryetarit të komunës rreth gjendjes financiare dhe ekonomike të Komunës së Junikut. 3. Informatë rreth përfundimit të periodës së parë për vitin shkollor 2019-2020 (realizimi i planit dhe suksesi i nxënësve). 4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete. 5. Të ndryshme.

Përfundim:

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Komitetit për Komunitete.

Komiteti për Komunitete:

Zejnepe Gaxherri _____
Kryesuese